- dh/1. Rekomandim për shqyrtimin-aprovimin e raportit të punës së Drejtorisë për Ndërmarrje dhe Shërbime Publike për vitin 2006 si dhe Rekomandim për vazhdimin e kontratës së punës drejtorit

7. Raporti i punës së Komisionit për vlerësimin e punës së drejtorit për Arsim
8. Raporti punës së Komisionit për vlerësimin e punës së drejtorit të ZLK
9. Të ndryshme

<i>Informat :</i>	Kuvendi Komunal i Gjilanit, të enjten me 14.06.2006 vendosi për shpalljen e konkursit për kryeshef dhe caktoi Zijadin Maliqin për ushtrues detyre. PDK-ja, e cila përbën opozitën më të fuqishme në Kuvendin Komunal të Gjilanit e ka tërhequr kandidatin e saj Fadil Osmani, nga pozita e ushtruesit të detyrës së kryeshefit ekzekutiv, ku ai ishte zgjedhur para më shumë se njëqind ditësh, me votat e koalicionit. Qemajl Mustafa, lider i këtij grupimi politik, i cili e arsyetoi këtë vendim, tha se PDK-ja është e detyruar që ta tërheq ushtruesin e detyrës së kryeshefit dhe këtë e ka arsyetuar me rrethanat e reja të krijuara, si në Kuvendin Komunal, ashtu edhe në raport me LDK-në, partnerin e koalicionit, i cili, sipas Mustafës, nuk iu ka përmbajtur marrëveshjes gojore për ndarje të drejtorive komunale dhe të zyrave kryesore. Në seancën e 38-të me radhë, nuk kanë marrë pjesë këshilltarët e LDK-së, përpos Artë Rexhepit, e cila në emër të grupit të këshilltarëve, sqaroi se ata ngelin pranë qëndrimit se Kuvendi duhet të vazhdojë procedimin me kandidatët tjerë për kryeshef ekzekutiv, nga lista e panelit intervistues dhe se kryetari nuk ka të drejtë të vendos për rishpallje të konkursit. Rexhepi tha se këto sqarime i përmban edhe shkresa e Ministrisë së Pushtetit Lokal. Kuvendi Komunal i Gjilanit është i përkushtuar që ta rikthejë normalitetin dhe hapi i parë i madh në këtë drejtim u bë më 14 qershor 2007. Në një takim të shëfave të grupeve të këshilltarëve komunalë me kryetarin e Kuvendit Komunal, Xhemajl Hyseni, është vendosur që brenda dy javëve të ardhshme, Kuvendi Komunal të mbajë dy seanca. Më 29 qershor, këshilltarët komunalë do të mbledhen në një seancë solemne për ditën e çlirimit të Gjilanit. Një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit do të mbahet më 2 korrik, përderisa seanca e radhës është caktuar për 9 korrik. Në anën tjetër zyrtarë komunalë kanë thënë se konkursi për kryeshef ekzekutiv si dhe drejtorë komunalë do të publikohet të martën. Në të vërtetë, konkursi për kreun e ekzekutivit si dhe shtatë drejtorë të drejtorive komunale është dërguar përpara se grupi i këshilltarëve të PDK-së ta ketë bërë një kërkesë të tillë te kryetari i Kuvendit, është mar nga : www.gjilani.komuna.org.
/ Seanca 29/06/2007 /	Duke u mbështetur në nenin 11 të Statutit të komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, më datën 29/06/2007, në një seancë solemne mori vendim që të shpallë 15 qershorin – ditë të çlirimit të Gjilanit, Manifestimet për festimin e 15 qershorit do të mbahen nën patronatin e Kuvendit Komunal dhe do të organizohen nëpërmjet Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Deri më tani, për tetë vite rresht, Gjilani, ka kremtuar ditët e lirisë nga data 12 deri 15 qershor. 15 qershori është një datë e veçantë për Gjilanin, edhe për faktin se pikërisht në këtë ditë në Gjilan kanë zbarkuar edhe paqeruajtësit amerikanë të KFOR-it, për t`i zëvendësuar ushtarët francezë, të cilët nga këtu kanë lëvizur në Mitrovicë.
/ Seanca 09/07/2007 /	Kuvendi Komunal i Gjilanit do të mbledhet më 9 korrik, në seancën e radhës, ku ndër të tjera do të shqyrtojë raportet e punës së drejtorive, rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale si dhe çështje të tjera. Në rend dite të seancës së 39-të do të jetë edhe Qendra Zejtare si dhe propozimi për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për orarin e punës, është mar nga : www.gjilani.komuna.org. Kuvendi nuk ka arritur të merret vesh as për rendin e punës, kryetari Xhemajl Hyseni e ka ndërprerë seancën, duke thënë se te këshilltarët komunalë nuk ka seriozitet për punë dhe nuk ka vendosmëri për t`i mbrojtur as vendimet që i kanë marrë vetë. Hyseni ka thënë se këshilltarët do të njoftohen ndërkohë për seancën tjetër, është mar nga : www.gjilani.komuna.org.
/ Seanca 15/10/2007 /	Kuvendi Komunal i Gjilanit do të takohet në seancën e radhës më 15.10.2007, në rend dite të kësaj mbledhje të Kuvendit Komunal të Gjilanit, e cila është edhe e fundit në këtë përbërje, janë vënë: Propozim-buxheti 2008, Rregullorja mbi tatimin në pronë si dhe Rregullorja për taksat komunale. Mbledhja mbahet në sallën e madhe të Kuvendit Komunal. Kuvendi Komunal i Gjilanit i ka dhënë fund punës së tij pesë vjeçare në përbërjen e tashme, pa arritur që ta miratojë propozim-buxhetin për vitin 2008 si dhe dy rregullore komunale. Opozita (PDK) nuk është paraqitur fare në senacë, përkundër faktit se këshilltarët e saj kanë marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ku është miratuar paraprakisht buxheti 2008 dhe kishin premtuar se vërejtjet e tyre do t`i bëjnë në Kuvend, ndërkaq këshilltarët e LDK-së ngelën pranë vërejtjeve për mosrrespektimin e procedurave për miratimin e buxhetit si dhe kërkesës për shtyerje të seancës. Në një situatë të tillë, kryetari i Kuvendit Komunal, Xhemajl Hyseni e ka përfunduar seancën si dhe e ka shpallur të mbyllur mandatin e kësaj përbërje, është mar nga : www.gjilani.komuna.org.

Bashkëpunimi me Organizata Ndërkombëtare dhe Institucionet tjera / 2007

* AER / Agjencioni Evropian për Rindërtim / European Agency for Reconstruction

Programi për Infrastrukturë Ekonomike dhe Sociale për Komuna /Municipal Social and Economic Infrastrukture Project
Është duke implementuar Programi për Infrastrukturë Ekonomike dhe Sociale për Komuna, vlera e projektit për çdo komunë është 360.000€ + (10 %) / pra 400.000 € , prioritet për komunën tonë është : Ndërtimi i ri i objektit të shkollës fillore në lagjen Zabeli i Sahit Agës, tenderi është shpallur gjatë fundit të muajit shkurt ndërsa është mbyllur me 27 prill 2006 , projekti prap është tenderuar (shtator-nëntor) . Gjatë muajit shkurt 2007 AER – e zgjedhe firmën – komanin Al Trade që ta përgatis projektin zbatues dhe ta implementoj .

* CDI / Community Development Initiatives / Prizren

Gjatë muajit dhjetor 2004, zyrtari për projekte ka aplikuar në program-projektin e CDI-ës.

Në listën e aplikimit nga komuna janë propozuar 11 projekte : të rrjetave të ujësjellësit dhe rrjeteve të kanalizimeve në zona rurale . Nga lista e projekteve janë aprovuar këto projekte : Malisheva e Epërme – Malisheva e Ulët – Kufca e Ulët – Gjilan,Velekincë – Pasjan / ose Pasjan – Velekincë, Pasjak – Koretishtë.

Në vlerën e kontraktuar të projektit do të participojnë me mjete financiare : Donatori (CDI) me (52%), Komuna me (28%), komuniteti (20%) . Projekti financohet nga Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA) ndërsa vetëm implementohet nga organizata lokale CDI – Prizren.

Në vitin 2005, janë bërë hulumtimet dhe shpuarjet testuese në lokalitetet e lartëpërmendura / Gjate muajit gusht 2006 janë shpallur tenderët për implementimin (finalizimin) e projekteve në fshatin Malishevë që pjesërisht është kompletuar rrjeti / Në vitin 2007 zyra e kryeshfit në muajin mars alokon shumën e mjeteve prej 76.500 € si participim në projektin e rregullimit të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Malishevë, po ashtu në muajin mars edhe në fshatin Koretishtë dhe Pasjak fillojnë punët në implementimin e projektit .

Me datën 28.07.2007 Malisheva e Poshtme dhe Malisheva e Epërme, fshatra këto të komunës së Gjilanit kanë përruruar ujësjellësin e ri, në emër të komunës, Lirie Kajtazi ka falënderuar SDC-në zvicerane dhe ADA-në austriake për mbështetjen financiare si dhe implementuesin - CDI për realizimin e projektit. Malisheva e Poshtme dhe e Epërme, që shtrihen rreth tri kilometra në lindje të Gjilanit, kanë mbi 600 shtëpi me mbi 3 mijë banorë, për këto fshatra është siguruar një potencial ujqor prej mbi 15 l/s, që është më tepër se standardi evropian.

* CRS / Catholic Relief Sevice & USAID / From the American People

Programi i Pajtimit dhe Bashkëpunimit Ndërkufitar Gjilan – Kumanovë - programi është 3 vjeçar dhe financohet nga CRS/USAID, qëllimi është të avancoj pajtimin ndëretik dhe demokracin lokale në komunitetet ndërkufitare në Evropën Juglindore . Aktivitetet thelbësore janë rritja e prodhimit dhe të tregtisë dhe aktivitetet kulturore dhe të rinisë .

Gjatë mesit të muajit mars CRS ka shpallur ftesa për dhënjën e granteve në vlerë 9500\$, qëllimi i programit është rritja e granteve të vogla për organizatat e agrobiznesit me qëllim të nxitjes së bashkëpunimit ndërkufitar bujqësor, këto grante do të rrisin mundësin ekonomike për fermerët dhe biznesin bujqësor, po ashtu CRS ka organizuar edhe trajnim për aplikuesit në këto grante ,, të gjitha OJQ lokale në Gjilan dhe Kumanovë kanë të drejtën të konkurrojnë në këto grante deri me datën 4 prill 2006 .Me 13 qershor në Gjilan / Në kuadër të projektit për bashkëpunim dhe pajtim ndërkufitar, në Gjilan u hap panairi ndërkufitar i agrobiznesit, ku prodhimet e tyre po i prezantojnë prodhues nga komunat Gjilan dhe Kumanovë. Ky është panairi i parë i këtij lloji në Gjilan. “Ky panair dëshmon përkushtimin e prodhuesve të dy vendeve dhe mekanizmit zbatues të këtij projekti për thyerjen e kufijve dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit mes popujve” .Projekti është mbështetur nga USAID-it , CRS-së si dhe komunat Gjilan dhe Kumanovë .

* Instituti Lindje Përendim / EastWest Institute

Bashkëpunimi Ndërkufitarë mes Komunave Gjilan – Preshevë – Kumanovë – Tërgovishte

Qëllimet e përgjithshme të Projektit GPKT janë: parandalimi i konflikteve dhe zhvillimi i komuniteteve në katër komunat e GPKT-së - Gjilanit në Kosovë, Preshevës në Serbinë jugore, Kumanovës në Maqedoni dhe Tërgovishtes në Serbinë jugore. Ky program mikro-grantesh është krijuar për ta:

- o inkurajuar zhvillimin e partneriteteve funksionale ndërkufitare dhe shumëetnike ndërmjet OJQ-ve dhe shoqërisë civile nga anët e ndryshme të kufijve të GPKT-së; dhe,
- o përkrahur ndërtimin e kapaciteteve për shoqërinë civile në këtë zonë dhe zhvillimin e kapaciteteve organizative për implementimin e aktiviteteve ndërkufitare dhe shumëetnike.

Aktiviteti : 1 Projekti GPKT i EWI-t i ka pasur dy raunde të mëparshme të mikrogranteve ndërkufitare në vitin 2004 dhe 2005, përmes të cilave janë financuar dymbëdhjetë projekte. Me qëllimin e inkurajimit të zhvillimit të partneriteteve ndërkufitare është publikuar *Doracaku i OJQ-ve dhe donatorëve të GPKT-së* si dhe është organizuar Panairi i OJQ-ve të GPKT-së në dhjetor të vitit 2006. Afati përfundimtar për dorëzimin e projekt-propozimeve është 15 marsi 2007. Të gjithë aplikuesit do të informohen për rezultatet e procesit të përzgjedhjes deri më 20 prill 2007. Këto grante janë në dispozicion për partneritetet e organizatave me përvojë (p.sh. OJQ-të ose organizatat me përvojë dhe njohuri relevante dhe janë të njoftuara me menaxhimin e projektit).

Aktiviteti 2 : GPKT Grupi Punues i Grave ka marr pjesë në ngjarjen *Buzëqeshjet Përtej Kufijve* në Preshevë me 5 Prill, 2007 – një ngjarje ndërkufitare shumëetnike për fëmijë dhe prindër nga Gjilani, Presheva, Kumanova dhe Trgovishte (GPKT). Buzëqeshjet Përtej Kufijve do të sjellin bashkë mbi pesëdhjetë fëmijë nga kopshtet parashkollore nga të katër komunat, prindërit dhe edukatorët dhe do të mirëpritet nga kopshti i fëmijëve 8 Marsi nga Presheva dhe parteri i tyre kopshti Proleterac nga Trgovishte.

*** Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA)**

Janë duke implementuar projekt programin : Zhvillimi i Resurseve Ujore në Kosovën Juglindore, ku janë të përfshira dy komuna Gjilani dhe Ferizaji / programi përfshin furnizimin me ujë në zonat rurale dhe zonat urbane (komponenta D), programi parashefë shfrytëzimin e ujërave nëntoksore në rrafshinën e lumit Morava e Binçës .

*** GTZ & AKK**

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), në bashkëpunim me projektin e GTZ-së “Modernizimi i Shërbimeve Komunale” ka ofuar ndihmë financiare për projektet komunale të shkallës së ultë me synimin për përmirësimin e shërbimeve komunale. Projekte të cilat do të financohen nga ky fond duhet të ndikojnë në rritjen e kursimit të energjisë në ofrimin e shërbimeve komunale (renovimi i objekteve publike, përmirësimi i sistemeve të ngrohjes, ndriçimi i rrugëve përmes ndriçimit që e kursen energjinë, reduktimi i harxhimit të energjisë në sigurimin e ujit të pijes, rigjenerimi i energjisë nga materialet e papërpunuara, biomasa, shfrytëzimi i opsioneve për përdorimin e burimeve të energjive të ripërsëritura, etj).

Komuna Gjilanit ka nevojë për ndihmën drejt zhvillimit të infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve komunale, projektet e identifikuar për programin në fjalë, janë të parapara edhe në Strategjin e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2005-2007 i cili është aprovuar nga Kuvendi i Komunës, Komuna e Gjilanit ka identifikuar projektet të cilat përputhen me këtë program, po ashtu ka marr për obligim të participoj 50% në vlerën e kontraktuar të projektit , projektet që janë bashkëfinancuar nga programi janë : (1) *Izolimi termik i mureve të jashtme të aneksit dhe fasadimi i jashtëm i objektit të shkollës fillore „ Rexhep Elmazi „* (2) *Ndërrimi i dritareve në objektin e Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër Pronë dhe Banim*, (3) *Revitalizimi i përgjithshëm i objektit të shkollës së ulët të muzikës (në shqyrtim).*

*** Parner Aid International Kosovo / PAI**

Kjo organizatë është e përqëndruar gjatë vitit 2006 në investime në sektorin e banimit dhe rindërtimit . Organizata në fjalë ka marrë përsipërm për të rregulluar gjërat elementare të shtëpive si për shembull: kulmi, izolimi, dritare, dyer , të një shtëpie në fshatin Koretishtë dhe ndërtimin e një shtëpie të re në lagjen nr. 8 në Gjilan .

Për vitin 2007 organizata PAI – ka dorëzuar kërkesat për participim në projektet që do të financohen nga organizata PAI (shuma e kërkuar është 8.750 €) , Organizata PAI do të ndërtoj disa shtëpi për familjet skamnore me sipërfaqe 60 dhe 80m2, ku sipas tyre vlera e tyre është 9.000 – 12.000€, po ashtu PAI ka kërkuar nga komuna (zyra e kryeshefit dhe e kryetarit të komunës) edhe krijimin e lehtësirave në përgatitjen e dokumentacionit (sepse procedurat e marrjes së lejes së ndërtimit janë shumë të gjata).

Komuna e Gjilanit posedon gatishmëri të plotë të përkrahjes së projektit të organizatës PAI pasi që është e nevojshme ngritja e urave të reja të bashkëpunimit reciprok, krijimi i lidhjeve midis organizatave të ndryshme të cilat kanë avancuar dhe po avancojnë ndërtimin e shtëpive për familjet në varfëri të skajshme .

*** UNDP - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)**

Gjatë *fazës së parë* të projektit në periudhën nëntor 2003 – shkurt 2005, që është financuar nga Qeveria Holandeze ndërsa është implementuar nga Organizata ARC-së përbushit qëllimin e tij me kthimin e 29 familjeve romë, programi ka kompletuar rehabilitimin e shtëpive për 7 familje shqiptare , komuniteti rom që është kthyer në fazën e parë të këtij projekti tani më të integruar.

Komuna e Gjilanit i propozon UNDP (Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara) të vazhdojë faza e dytë e projektit për kthimin e familjeve romë të shpërngulura jashtë Kosovës, në vendin e tyre të banuar nga ta, në Mahallën e Romëve në Abdullah Presheva, që gjendet në një zonë urbane në qytetin e Gjilanit .

Faza e dytë e këtij projekti do të ketë një efekt të shumëfishtë në të arriturat e projektit të parë për kthim në Abdullah Preshevë, pasi që komuniteti rom që jeton në Gjilan do të rritet deri në një shkallë më të konsiderueshme, Qeveria komunale do të ketë arsye më të madhe të përqendrohet në mbrojtjen e të drejtave dhe brengave të këtij komuniteti në vazhdimësi.

Komuna ka paraparë që ky projekt gjatë implementimit të ketë dy komponentë :

- a) Kuvendi Komunal i Gjilanit : do të realizoj komponentin e fortë (ndërtimin dhe rehabilitimin e objekteve - për 25 familje dhe infrastrukturën – rrugët)

- b) Organizata Mercy Corps – Prishtinë : do të realizoj komponentin e butë (vizitat jashtë kufitare, ndihma ekonomike të qëndrueshme, (aspektin socio-ekonomik)

Përfutues : Direkt 25 familje - indirekt do të jenë më shumë se 1,500 banorë të komunitetit rrethues

Me datën 26.07.2007 ne sallene Kuvendit Komunal ne Gjilan janë nënshkruar Marreveshjet tripalshe (TPA), prezent ishin 22 përfutues nga lista e aprovuar, nga përfutuesit prezent vetem (Shaban Demiri AP 003) nuk ka pranuar te neshkruaj marreveshjen (TPA) ma arsyetim se nuk eshtepajtuar me siperfaqen e merimetimit te objektit qe i ka takuar sipas numrit te anatrve, ndersa dy perfitesit tjer (AP 008 & AP 019) nuk kan ardhe. Në takimin e TF më dt. 31.07 u vendos që përfutuesit Shaban Demiri ti rregullohet edhe një dhomë në katin e parë, dhe i njeiti pastaj e nënshkroi MTP (TPA), gjithashtu edhe Agim Ramadani e ka nënshkruar MTP (TPA) më dt. 29.07.07.

Me datën 10.08.2007 eshte bere shpallja e tenderit, ndersa me daten 24.08.2007 eshte bere mbyllja e tenderti, komisioni vlersues ka rekomanduar per Lot 1 : kompanin Anra : 91.883,03 €, ndersa per Lot 2 : 107.199,48 € kompanin Mozaiku .

* ZYRA NDËRLIDHËSE E BRITANISË -UK GOVERNMENT

Gjatë muajit mars 2007 (konkretisht 22.03.2006) aprovohet dhe nënshkruhet MiM për projektin rregullimi i rrjetit të kanalizimit ne fshatin Shillovë, nënshkruet të këtij MiM janë : David Blunt, Shef i Zyrës Britanike, Prishtinë, Ministër Lutfi Haziri, Ministër i Pushtetit Lokal dhe Xhemajl Hyseni, Kryetar i Komunës së Gjilanit .

Shuma totale e fondacionit e caktuar për projektin nuk do të kaloj shumë prej 250,000 eurosh. Instalimi i parë prej 150,000 eurosh do të paguhet brenda dy javësh nga nënshkrimi i MiM. Instalimi i dytë i 70,000 eurosh do të paguhet pasi dhuruesi kompetent do të pranoj një interim financiar të kënaqshëm dhe raportin e rradhitjes. Vendosi finale e 30,000 eurove do te paguhet pasi që të kompletohet projekti dhe pasi të pranohet raporti financiar final dhe i rradhitjes.

* Qeveria e Kosovës (Ministrit)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) : Rregullimi i shtratit të lumit “Mirusha” është një nga projektet më të rëndësishme për qytetin e Gjilanit, i cili fillon së realizuari këtë vit. Komuna e Gjilanit e ka nënshkruar në Prishtinë një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rregullimin e shtratit të lumit “Mirusha”, me këtë projekt do të arrihet që një moçal kundërmues, siç është bërë ky lumë, të shndërohet në një ambient rekreacioni, që në aspektin hapësinor është jetike për qytetin e Gjilanit. MMPH merrë pjesë në këtë projekt me 225 mijë Euro, përderisa komuna do të bashkëfinancojë me 47 mijë Euro dhe kjo do të jetë vetëm faza e parë e projektit, por që krijon mundësi për të kërkuar donatorë tjerë për rregullimin e tërësishëm të shtratit të lumit “Mirusha” dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për ujra të zeza. Për zgjidhjen e plotë të këtij problemi kërkohen më shumë mjete dhe komuna nuk ka mundësi buxhetore ta përballojë një projekt kaq të madh.

Ministria e Pushtetit Lokal (MPL) : në parim ka aprovuar projektin e restaurimit të kalasë të Pogradjës. Projekti është përgatitur në bashkpunim të mirë mes Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv me Qendren Rajonale për Trashegimi Kulturorë – në Gjilan dhe në mbështetje të fuqishme të Ministrisë së Pushtetit Lokal. Shuma e aprovuar është 20. 000 € .

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) : gjate vitit 2007 janë tenderur nga MASHT keto projekte : Ndertimi i aneksit te shkollës fillore “Musa Zajmi” Gjilan, Ndertimi i aneksit të shkollës fillore “Selami Hallaqi” në Gjilan, ndertimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Bukovik .

Rezyme : Zgjedhjet 2007

Vota e 17 nëntorit 2007 : ka përcaktuar edhe përbërjen e Kuvendit Komunal, i cili do t`i ketë 41 këshilltarë dhe dominohet nga PDK-ja, megjithëse asnjë subjekt nuk e ka arritur shumicën e thjeshtë të mandateve në Asamblenë Komunale dhe koalicionet janë të domosdoshme.

PDK, ka fituar 14 ulëse në Asamblen Komunale të Gjilanit, LDK-ja - 9 vende, LDD-ja - 6, AKR-ja – 6, AAK-ja - 4 vende, ORA dhe Partia e Drejtësisë – kanë fituar nga një vend.

Bartësi i listës për këshilltarë komunalë nga rradhët e PDK-së në Gjilan, Fadil Osmani, doli kandidati më i votuar në këto zgjedhje, me 5.058 vota. Osmani ka lënë mbrapa edhe kandidatin e LDK-së, Lutfi Hazirin, i cili ka marrë 3.853 vota. Ndërkaq, ndër kandidatet femra, më të votura është Shukrije Rapuca (PDK).

Këshilltarët komunalë: **PDK :** Fadil Osmani (5058 vota), Sami Hoxha (2611), Abdylatif Latifi (2516), Shukrije Rapuca (2311), Shkëlqim Latifi (2288), Bujar Nevzadi (2279), Nisret Hajrullahu (2067), Ilir Tahiri 2035, Shefik Selimi (2029), Bajram Shaqiri (2017), Nushe Hamdiu (1588), Arzie Nuhiu (1560), Rozelita Hasani (1404), Mirvete Kurteshi (1382). **LDK:** Lutfi Haziri (3853), Arben Mehmeti (2312), Agim Rexhepi (1977), Agim Salihu (1525), Rashit Sahiti (1463), Linda Kallaba (1296), Nehat Faik Ramadani (1292), Arta Rexhepi-Berisha (1251) dhe Hymryze Shkodra (911). **LDD:** Jakup Bajrami (1881), Zijadin Maliqi (1696), Isah Bunjaku (1557), Besim Guda (1538), Saranda Bllaca (921)

dhe Sanije Elezi (847). **ARK** : Islam Zuzaku (2106), Omer Daku (1076), Mimoza Shkodra (1052), Arben Maliqi (1006), Nazif Sylejmani (947) dhe Mizaferi Ismajli (756). **AAK** : Ejup Haziri (893), Fadil Gashi (779), Maxhide Shaqiri (648) dhe Luljeta Kadriu (584). **ORA** : Halim Vranovci (371). PD: Bekim Isaku (371).

Vota e 8 dhjetorit 2007 (votimet për balotazh) - : Të dy kandidatët e kualifikuar për balotazh (Qemajl Mustafa (PDK) dhe Lirije Kajtazi (LDK) ishin shprehur optimistë për fitore, pasi kishin dalur nga dhomat e votimit. Bazuar në rezultatet parapërfundimtare, Qemajl Mustafa (PDK) ka marrë 13 mijë e 878 vota, apo 67.29 për qind, ndërsa Lirije Kajtazi (LDK) ka marrë 6 mijë e 746 vota, apo 32.71 për qind të votave. Ajo e ka uruar kundërkandidatin e saj për fitore.

Qemajl Mustafa, kryetar i ardhshëm i Gjilanit, ka thënë se e ka pritur këtë rezultat, pasi që ai ka udhëhequr bindshëm edhe më 17 nëntor. "Kjo fitore është një rikorfimim i besimit të qytetarëve të komunës për mua dhe ky besim kaq i denjë, të cilin ata ma dhanë votë, më bënë edhe më obligativ ndaj kërkesave të tyre dhe premtimeve të mia, , ka thënë Mustafa.

Mustafa tha se ardhja e tij në postin e kreut të komunës, do të jetë e njëtrajtshme për të gjithë, sepse ai do të jetë kryetar i të gjithëve, i atyre që e kanë votuar dhe i atyre që s`e kanë votuar, njësoj sikurse edhe i atyre, të cilët që për ndonjë arsye nuk kanë dalë fare në votime, është mar nga : www.gjilani.komuna.org.

Seanca inauguruese e Kuvendi Komunal

Në Gjilan, të enjten me datën 27/12/2007 është mbajtur seanca inauguruese e Kuvendit Komunal, ku në mënyrë solemne është bërë bartja e pushtetit të përbërja e re dhe kryetari i ri i Komunës, Qemajl Mustafa, i cili në zgjedhjet e nëntorit doli fitues.

Kryetari në largim, Xhemajl Hyseni, para të zgjedhurve të rinj ka thënë se periudha në të cilën po hyjmë është ndër periudhat më të rëndësishme për institucionet nacionale dhe lokale. Është periudha e definimit të statusit të Kosovës, e krijimit të shtetit dhe e krijimit të institucioneve shtetërore.

Komunat do të jenë institucione shumë të rëndësishme e posaqërisht Gjilani, si komunë kufitare, me përbërje shumëetnike dhe me pozitë shumë specifike në pakon e Ahtisarit. Ai i ka rikujtuar këshilltarët e rinj me problemet, të cilat i presin ata gjatë mandantit dy vjeçar, si çështjet sociale, papunësia, uji i pijshëm, ujrati e zeza, infrastruktura, problemet në arsim dhe shumë sfida të tjera .

Kryetari i ri i Komunës, Qemajl Mustafa, pasi e dha betimin, në një fjalë rasti që mbajti në seancën inauguruese, tha se bartja e pushtetit nga një formacion i asamblesë në tjetrin dhe nga një kryetar komune, te një tjetër, është akt i rëndomtë në jetën plurale demokratike.

Ai ka falënderuar në cilësinë e kryetarit të komunës, të gjithë ata që morën pjesë në garën demokratike për pushtet lokal dhe sidomos ka falënderuar qytetarët e Gjilanit për kontributin dhe kulturën e lartë demokratike që treguan gjatë kohës sa zgjati kjo garë, deri në përmbyllje të saj. "Ishte kjo edhe një sprovë e pjekurisë politike të shoqërisë sonë, të cilën e kaluam me sukses", ka thënë Mustafa.

Kreu i ri i komunës e ka vlerësuar lartë edhe mundin dhe të gjitha përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në Gjilan dhe i ka falënderuar të gjithë për punën e mirë që kanë bërë në avansimin e kulturës demokratike, të sigurisë dhe të jetës në tërësi, në këtë komunë, i bindur se ky bashkëpunim i mirë do të vazhdojë edhe tani dhe në të ardhmen.

Më tutje, në fjalën e tij inauguruese para Kuvendit Komunal, Mustafa ka thënë se është i vetëdijshëm se po merrë përgjegjësi dhe jo privilegje, në një kohë mjaft sfiduese, ashtu siç ka kërkuar që të jenë të vetëdijshëm për këto përgjegjësi edhe këshilltarët e posa zgjedhur, të cilët do të jenë në këtë shtëpi për dy vitet e ardhshme, për t`i përfaqësuar denjësisht dhe për të qenë në shërbim të plotë të qytetarëve.

Për më tepër, ai i ka sugjeruar këshilltarët e rinj që tekstin e betimit ta lexojmë secilën herë kur i marrim materialet për seancat e asamblesë komunale dhe komiteteve të tij. "Kjo do të na përkujtojë gjithnjë se jemi të deleguar në një mision të rëndësishëm, me besimin dhe bindjen e mijëra njerëzve, të cilët presin kryerjen me sukses të këtij misioni", ka thënë ai, duke premtuar se të do të jetë në shërbim të plotë të qytetarëve.

Të tjera :

Zyra e projekteve me datën 18/12/2007 aplikon për Çmimi i Europës / Katër merita Evropiane / Destinuar Kolektiviteteve Lokale / Europe Prize / For European awards for local and regional authorities .

Komuna e Gjilanit është fituese e çmimit "Diploma Evropiane" në vitin 2005 kjo ka qenë një nga rezultatet më të mëdha, "Diploma Evropiane" është njëri nga katër çmimet më të larta që ndan Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës .

Përgatitur nga : Fadil OSMANI, Zyrtar për projekte
E-mail : fadilosmani02@yahoo.com